



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Neni 9 i ligjit nr .10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikon se:

“Titullari i institucionit publik qendror të artit dhe kulturës ushtron këto kompetenca:

- a) është përfaqësuesi ligjor i institucionit në marrëdhënie me të tretët;*
- b) drejton veprimtarinë administrative dhe organizative të institucionit dhe ndjek zbatimin e vendimeve të bordit artistik;*
- c) administron burimet financiare të institucionit;*
- ç) zgjedh dhe emëron personelin;*
- d) kryen të gjitha detyrat e tjera që i ngarkon ky ligj dhe statuti.*

2. Mënyrat dhe procedurat e ushtrimit të kompetencave të titullarit përcaktohen në statut”.

Në vijim të pikës 2 të nenit si më lart cituar, neni 15 i Statutit të TKOBAP-së të miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 166, datë 27.4.2015 parashikon se Drejtori i Përgjithshëm:

- “a) Drejton veprimtarinë e TKOBAP-së në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin e institucionit dhe Rregulloren e Brendshme të funksionimit të tij;*
- b) Përfaqëson TKOBAP-në në marrëdhënie me të tretët. Në mungesë të tij autorizon me shkrim njërin nga Drejtorët;*
- c) Emëron dhe liron në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës të gjithë vartësit e tij;*
- d) Nxjerr urdhra dhe udhëzime me karakter të brendshëm për punonjësit e TKOBAP-së;*
- e) Përcakton strukturën e organizimit sipas sektorëve”.*